



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Petrit Vasili – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar””. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Petrit Vasili, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Nuri Belba, Floida Kërpaçi, Halim Kosova, Flamur Golemi, Roland Xhelilaj, Nora Malaj dhe Eglantina Gjermani.

Mungojnë:

Elisa Spiropali, Bardh Spahia, Grida Shqina, Orjola Pampuri, Vangjel Tavo, Lindita Metaliaj dhe Arben Kamami.

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafaj – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna – Drejtor Juridik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Arta Mandro – Eksperte në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etleva Sheshi – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Petrit Vasili – Fillojmë mbledhjen e komisionit, sipas rendit të ditës të miratuar dhe të dakordësuar në kalendar.

Sot kemi shqyrtimin në parim të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar””. Kjo nismë është depozituar në Kuvend, nga Këshilli i Ministrave, është futur në kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe është miratuar.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë është komision për dhënie mendimi. Sot do të bëjmë shqyrtimin në parim të këtij ligji, më tutje, sipas kalendarit të vendosur në mënyrë të dakordësuar në mbledhjen e komisionit, do të kemi edhe dy mbledhje të tjera të komisionit, njëra që ka të bëjë me dëgjimin e grupeve të interesit dhe tjetra ka të bëjë me miratimin nen për nen dhe në tërësi të nismës nga ana jonë, në fund do t’i përcjellim opinionin tonë Komisionit përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Për shqyrtimin e kësaj nisme në mbledhje marrin pjesë: Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Mirë se keni ardhur, zonja Ministre!

Zonja Merita Xhafaj, zonja Antoneta Njehrrëna, zonja Arta Mandro dhe zonja Etleva Sheshi. Këto janë emrat e referuar nga stafi. Nuk e di nëse janë prezentë apo jo. Nëse nuk janë prezentë, evidentoni kush nuk është, në mënyrë që të mos mbeten në rekordet e komisionit si të ftuar, ndërkohë që nuk janë prezentë.

Vazhdojmë me shqyrtimin e ligjit. Mendoj se, para se të fillojmë debatet apo pyetjet, t’i jap fjalën ministres Manastirliu mbase për një përmbledhje të thelbit të nismës. Komisioni është i interesuar të dijë se cilat janë pjesët që ndryshojnë dhe reflektimet e tyre në ligjin përkatës, në mënyrë që edhe komisioni të jetë me i qartë se cilat janë risitë që sjell kjo nismë në krahasim me ligjin e mëparshëm.

Fjala është për ju, zonja Ministre.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit, kryetar!

Më lejoni të paraqes këtu para jush propozimin e Këshillit të Ministrave për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar””.

Arritja e barazisë gjinore dhe reduktimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje tashmë artikulohej qartësisht si prioritetet dhe drejtimit kryesore për zhvillim në një tërësi dokumentesh e programesh kombëtare, duke u konsideruar si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Përmirësimi i legjislacionit dhe harmonizimi i tij me standardet e BE-së dhe dokumenteve të ratifikuara nga parlamenti shqiptar janë detyrime që duhen përmbushur në vazhdimësi nga strukturat përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje.

Ligji që ne po sjellim për ndryshime dhe shtesa, nëse i kthehemi momentit kur ai është miratuar për herë të parë nga parlamenti shqiptar, erdhi si një iniciativë qytetare me 20 000 firma në vitin 2006 dhe ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2007, duke krijuar bazën ligjore të domosdoshme për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Kuadri ligjor u përmirësua me ndryshimet që pësoi ky ligj në vitin 2008, ku për herë të parë janë futur edhe autoritete të tjera përgjegjëse. Më tej është ndryshuar në vitin 2010, ku përveç përfshirjes në këtë ligj të një strukture ndihmëse për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje si një qendër speciale. Gjithashtu, janë parashikuar edhe organe të tjera, të cilat mund të kërkojnë urdhrat e mbrojtjes për fëmijët, siç është policia dhe prokuroria, pra duke vendosur brenda këtij ligji edhe këto ndryshime të domosdoshme për atë kohë.

Nga viti 2010 dhe deri më tani nuk ka pasur asnjë ndryshim dhe propozim ligjor. Ndërkohë, në vitin 2014 është vlerësuar në praktikë ecuria e këtij ligji, zbatueshmëria e tij dhe janë identifikuar ato vakuume, të cilat kërkojnë një plotësim ligjor më të mirë, në mënyrë që mbrojtja e vajzave dhe grave dhe çështja e dhunës në familje të ketë sa më shumë efikasitet gjatë zbatueshmërisë. Ndryshimet në Kodin Penal në vitet 2012 dhe 2013 e ngritën në një shkallë më të lartë mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, duke e parashikuar dhunën në familje si vepër penale.

Ratifikimi i Konventës së Stambollit dhe detyrimet që sjell ajo, rekomandimet e dhëna në kuadër të konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave CEDAW” dhe procesi i integritetit evropian sollën nevojën e kryerjes së analizës së kuadrit ligjor ekzistues në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje. Analiza e përputhshmërisë së legjislacionit të dhunës në familje me detyrimet ndërkombëtare u krye me mbështetjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara, UNDP, dhe është vijuar me përfshirjen në këtë analizë dhe në ndryshimet ligjore të ekspertëve, të cilët, së bashku me Ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kanë punuar projektligjin që ne prezantojmë sot.

Duke iu referuar statistikave, vetëm në 9 muajt e parë të vitit 2017, duke e krahasuar edhe me vitet e mëparshme, janë regjistruar 4543 denoncime për dhunë në familje, rreth 19,4% më

shumë se në vitin 2016. Kjo do të thotë se ka një ndërgjegjësim më të madh për sa i përket denoncimit të dhunës, por, gjithashtu, ka edhe një rritje të besimit në lidhje me këto problematika, të cilat zgjidhen më mirë dhe më shpejt nga organet dhe mekanizimi kombëtar referues. Në përgjigje të rasteve të shtuara të denoncimit të dhunës në familje, në disa raste me pasoja tragjike, domosdoshmëria e harmonizimit me dokumentet dhe detyrimet ndërkombëtare dhe problematikën e dala gjatë zbatimit të këtij ligji nga autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe gjykatat sjellin nevojën e rishikimit të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar””.

Shtesat dhe ndryshimet e propozuara, si dhe plotësimi i kuadrit nënligjor përkatës synojnë që gjatë zbatimit të ligjit të përmirësuar efektet të jenë në: parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në familje; rritjen e eficiencës dhe bashkëpunimit të strukturave përgjegjëse që punojnë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe rritjen e pjesëmarrjes së dhunuesve në shërbimet specifike të rehabilitimit, me fokus të veçantë dhunuesit e alkoolizuar, të droguar ose me probleme të shëndetit mendor, të dhëna qartësisht në vendimet e gjykatave për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe rritjen e mbështetjes së kualifikuar gjyqësore falas për viktimat e dhunës në familje.

Risite që parashikon ky projektligj janë: përmirësimi i masave mbrojtëse të parashikuara në ligj, në kuadrin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrit të mbrojtjes, duke pasur parasysh sidomos përmirësimin e masave mbrojtëse për fëmijët dhe të të gjitha subjekteve të mbrojtura; rritja e sigurisë që jep Policia e Shtetit nëpërmjet urdhrit paraprak të mbrojtjes së menjëhershme. Urdhri paraprak i i mbrojtjes së menjëhershme është një mekanizëm i ri i futur për herë të parë në këtë ligj, të cilin e sjellim për ndryshim, për të dhënë më shumë garanci në trajtimin e rasteve të dhunës dhe për të dhënë më shumë garanci për mbrojtjen e viktimave. Në një kohë kur ligji aktual krijonte një boshllëk në 24 orët e para të rasteve kur denoncoheshin në polici, me miratimin e këtij ligji policia do të mundet të lëshojë urdhër paraprak të menjëhershëm mbrojtjeje për të pasur më shumë garanci për trajtimin e viktimave të dhunës.

Gjithashtu, risi të këtij projektligji janë: rritja e ndihmës së kualifikuar gjyqësore falas nëpërmjet detyrave të parashikuara për Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin e Ndihmës Juridike; përcaktimi i afateve të qarta procedurale për regjistrimin e kërkesës për urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe për ankimet ndaj vendimeve gjyqësore; parashikimi shprehimisht i detyrimit të organeve shtetërore për të ofruar falas çdo shërbim ekspertize për rastet e dhunës në familje. Edhe ky ndryshim parashikon që çdo shërbim ekspertize,

duke filluar nga ndihma ligjore falas, edhe në kuadër të harmonizimit me legjislacionin e ri, por edhe ekspertiza psiko-sociale dhe ekspertiza mjeko-ligjore të jenë dhe të ofrohen falas pa penguar ecurinë e procesit dhe të garantohen falas për viktimën e dhunës në familje.

Gjithashtu, ky ligj përcakton shumë qartë organet përgjegjëse, autoritetet përgjegjëse, detyrat e tyre dhe përgjegjësitë e zyrtarëve, të cilët merren me rastet e dhunës në familje. Pra, në këtë ligj përcaktohen qartë të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat e tyre. Unë nuk doja të ndalesha në veçanti të ndryshimet nen për nen, pasi besoj se do të kemi një seancë tjetër dëgjimore, ku gjatë shqyrtimit nen për nen do të prezantohen të gjitha ndryshimet që janë parashikuar në këtë projektligj, ndaj jemi të hapur për pyetje dhe diskutime në këtë kuadër.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Ministre!

Nga stafi juaj a ka dikush tjetër diçka për të shtuar? Nuk ka.

Pas këtij prezantimi në parim, kushdo nga kolegët që ka pyetje, komente apo diskutime lidhur me projektin e paraqitur, është i mirëpritur t'i bëjë.

Atëherë, po e filloj unë me disa pyetje, për të hapur edhe debatin.

Praktikisht, në relacionin që shoqëron ligjin thuhet se janë marrë masat për të siguruar gjykimin në një afat të shpejtë. Nga leximi i ndryshimeve të sjella, me përjashtim të sigurimit të bërjes së një seancë brenda 20 ditëve, pashë që nuk ka një mundësi reale për të bërë një gjykim të shpejtë. Në rast se ka ndonjë gjë që mund të na ketë shpëtuar, na e sqaroni.

Së dyti, u përmend se ndihma e kualifikuar ligjore do të bëhet nga një bashkëpunim apo një marrëveshje me Dhomën e Avokatisë. Pyetja është: përderisa shteti ka instrumente të tilla, siç është Avokatura e Shtetit, që është një institucion tërësisht në varësi të qeverisë dhe është në tagrin e saj që gjithë këtë strukturë ta përdorë sipas situatave, pse nuk përdoret instrumenti që kemi në dorë, i cili paguhet nga qeveria, dhe përdoret një instrument tjetër? Saktësisht ka edhe një problem tjetër, Dhoma e Avokatisë në këtë rast do të jetë e shtrënguar që të punojë gratis, apo shërbimet e saj do t'i paguajë shteti? E bëj këtë pyetje, pasi aktivizimi i instrumentit, siç janë instrumentet e Avokaturës së Shtetit, nuk implikon pagesa dhe tarifa, sepse praktikisht është një institucion varësie.

Së treti, në fund të relacionit ka një vlerësim të përgjithshëm, gjë që ne, me thënë të drejtën, në Kuvend nuk e kemi toleruar as për një nismë të zakonshme që vjen nga një deputet i caktuar, lidhur me shpenzimet buxhetore që imponon miratimi i një ligji të tillë.

Së pari, në çfarë mase janë këto shpenzime buxhetore? Ky është një informacion që komisioni kërkon ta dijë?

Së dyti, në qoftë se gjithçka ecën në rregull, dhe unë nuk shikoj ndonjë surprizë, ligji do të miratohet dhe do të hyjë shpejt në fuqi. Por unë dua të di: sa është masa e këtyre shpenzime buxhetore dhe si do të përballohen në gjysmën e dytë të vitit, kur ligji do të jetë aktiv? A janë parashikuar fonde për këtë gjë? Në qoftë se po, sa janë dhe cilat janë? E them këtë, sepse e gjithë kjo nismë bëhet, pikërisht, për të pasur një impakt të drejtpërdrejtë, konkret dhe të shpejtë. Në rast se këto instrumente nuk janë të kthjelluara dhe të qartësuara, sigurisht më pas mund të krijojnë mosfunksionimin e ligjit në praktikë.

Pyetja tjetër është: ku janë menduar dhe ideuar që të ngrihen qendrat e emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave, pasi rritja e numrit të viktimave është një realitet, i cili është i përditshëm dhe, për fat të keq, për arsye të caktuara shoqërore, ky fenomen sa vjen dhe shtohet? Pra, emergjenca e tij nuk zbehet, por theksohet. Kur parashikohet ligji, natyrshëm parashikohet edhe një infrastrukturë mbështetëse, e cila duhet të konsiderohet një infrastrukturë kyçe për ta zgjidhur problemin. Prandaj, në projektin apo në idenë paraprake, sa qendra të tilla do të jenë dhe ku do të vendosen? Domethënë, a do të ketë një gjeografi të caktuar se ku do të jenë të përqendruara?

Pyetja e dytë është: ku do të jenë strukturat trajnuese, do të jenë të vendosura më vete dhe çfarë madhësie do të kenë? A ka fonde për ngritjen e këtyre strukturave? Po ashtu duhet të sqarohet: strukturat për monitorimin e zbatimit të ligjit do të jenë të përqendruara në Ministrinë e Shëndetësisë, do të jenë të decentralizuara, të dekoncentruara diku gjetkë, do të ngrihet një mekanizëm, një instrument për t'i bërë ato? Në rast se do të ngrihet, ku do të jetë i vendosur dhe çfarë njerëzish do të ketë?

Njëherazi, problem më vete është monitorimi i ekzekutimit të urdhrave mbrojtës dhe urdhrave të menjëhershme të mbrojtjes. Kjo do të jetë kompetencë e Ministrisë së Çështjes Sociale dhe Shëndetësisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, apo kujt? E bëj këtë pyetje sepse ky është një veprim që mbart pasoja juridike, prodhon pasoja juridike dhe kërkon edhe një mekanizëm të caktuar të monitorimit të vazhdueshëm. Këto pyetje kam për momentin.

Ogerta Manastirliu – Në lidhje me pyetjet, pavarësisht se ne bëmë një prezantim paraprak të ndryshimeve ligjore, patjetër që do t'i shikojmë të gjitha nenet një për një, ku besoj se do të ketë edhe më shumë shpjegime për ndryshimet dhe amendimet që propozohen, më lejoni t'ju jap disa të dhëna.

Në lidhje me pyetjen e parë, saktësimi i afateve procedurale, ky është një projektligj që vjen për shtesa dhe ndryshime. Domethënë, baza e tij është në ligjin aktual dhe reflekton ndryshime, si dhe mirëpërcakton afate, të cilat vendoseshin apo nuk definoreshin në ligjin aktual, siç ishte, për shembull, urdhri paraprak i menjëhershëm i mbrojtjes, i cili vjen si një definicion i ri në këtë ligj dhe nuk parashikohet në ligjin aktual dhe vjen për mbrojtjen e viktimës. Viktima kur denonconte dhe vinte në polici, 24 orët e para, derisa gjykata të merrte vendim, ishte e pambrojtur dhe duhej referuar nga policia, referohej apo referohet edhe sot me këtë ligj, në një qendër të specializuar deri në momentin që gjykata të merrte një vendim. Propozimi që vjen me këtë projektligj është se policia të mundet të japë urdhrin paraprak të menjëhershëm për mbrojtjen e viktimës dhe më pas ta garantojë dhe të drejtojë në gjykatë për urdhër të menjëhershëm të mbrojtjes dhe vendimin e gjykatës.

Në ndryshimet e propozuara shtohen disa pika shumë të rëndësishme, ku gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur apo duhet të zgjidhet nëpërmjet alternativave të pajtimit apo ndërmjetësimit, gjë që nuk ishte në ligjin aktual, dhe që këtu futet shteti si garant, dhe nuk i lihet më viktimës apo marrëdhënieve në çift, që të gjithë e dimë se sa shumë vulnerabilitet ka në ato momente. Pra, del shteti si garant për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje. Kjo është një risi që sjell ky projektligj, në funksion të mbrojtjes së viktimës dhe të garantit shtet në këtë kuadër.

Nga ana tjetër, një pikë shumë e rëndësishme është përsëri vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Pra, vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me zyrën e përmbartimit dhe me zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore, ku janë në...

Petrit Vasili – Zonja Ministre, jam i qartë në lidhje me këtë çështje. Ka një përcaktim të gabuar në relacion. Nuk e di kush e përgatiti relacionin, ju apo...

Ogerta Manastirliu - Relacionin e përgatisin ekspertët dhe janë drejtorë prej vitesh në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, megjithatë besoj se është me shumë interes që ta përshkruajmë çështjen tuaj.

Petrit Vasili – Në mënyrë specifike kam një gjë, për të thënë për t'u kursyer edhe kohën kolegëve. Në relacion ka një përcaktim të gabuar, pasi sigurohen masa për të siguruar gjykimin e shpejtë, këto masa për gjykimin e shpejtë as nuk janë dhe nuk mund të jenë. Ky është një përcaktim profesionalisht i gabuar. Jam plotësisht dakord me gjithçka që ju referoni, por nuk kanë lidhje me pyetjen time. Këtu është fare e qartë që ka disa risi pozitive, pa diskutim që po, për nxjerrjen e

urdhrit në mënyrë të menjëhershme e të tjera. Këto kanë të bëjnë me masat që janë paraprake në momentin që dhuna është evidentuar dhe janë shumë të domosdoshme dhe shumë të mira, por ky përcaktim, për të siguruar gjykimin e shpejtë, nuk duhet të ekzistojë këtu, pasi krijon një iluzion, i cili është i pamundur për t'u influencuar nga qeveria. I gjithë procesi i gjyimit ndodh në një pushtet tjetër, i cili nuk varet nga qeveria, është një pushtet i pavarur dhe se sa zgjat një gjykim kurrkush nuk mund ta dijë. Do të ishte mirë që të kishim disa limite, ku të thuhet se çdo gjë duhet të ndodhë brenda kaq kohësh dhe të merret vendimi. Dakord, do të ishte shumë mirë, do të ishte një reformë e madhe, por kjo reformë nuk ka ndodhur. Kështu kjo që thatë është fare e qartë, plotësisht ndaj të njëjtat mendime me ju për gjithçka që shpjeguat, por nuk lidhet me këtë çështje. Kështu, vazhdojmë me pyetjet e tjera.

Ogerta Manastirliu – Ndërkohë, ka një parashikim, i cili përfshihet përsëri në këtë projektligj, ku specifikon: “Jo më vonë se 20 ditë nga dita e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata kryen seancën. Pra, vendosë një përcaktim afatesh ky projektligj.

Sa i përket pikës tjetër...

Petrit Vasili – Masa e gjyimit të shpejtë do të thotë nga pikëpamja juridike sa do të zgjasë një proces. Pra, për daljen në fillim gjykimi, këta që janë juristë e dinë shumë mirë, palët mund të bëjnë ato gjëra që mundësitë juridike u krijojnë, mund të mos kenë avokatin, mund të mungojë prokurori, kështu që tërhiquni nga kjo gjë, sepse kjo nuk ka vlerë. Janë gjëra kaq pozitive të tjerat, sa që të krijosh një iluzion të tillë është të humbësh kohën kot. Kështu që më mirë të ecim me të tjerat.

Ogerta Manastirliu – Nga ana tjetër, do të doja të saktësoja se kush i monitoron. Po ndalem te kjo çështje, sepse shkon në lidhje logjike me të tjerat.

Petrit Vasili - Jo, pyetja e dytë ishte për mbrojtjen e garantuar nga avokatia, nuk ka problem, zgjidhni ju radhën që doni, por përgjigjuni të gjitha pyetjeve.

Ogerta Manastirliu – Pra, për të vijuar logjikisht me disiplinimin e afateve për urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes, përcaktimi i ri vendos njësinë, zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore për të monitoruar respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, në të cilin vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat periodike në banesë me përfaqësues të zyrës së shërbimeve sociale dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes duke dhënë informacionin e nevojshëm.

Sa i përket pyetjes tjetër, në lidhje me dhomën e avokatisë, një pikë ku ky projektligj ndërhyr, është pikërisht ndihma ligjore falas që i garantohet viktimës dhe, nga ana tjetër, përcakton që dhoma e avokatëve, pikërisht si një institucion varësie, do të mundet të certifikojë avokatë të trajnuar për ndihmën ligjore falas, pra duke dhënë kështu viktimave të dhunës një garanci më shumë për të pasur avokatë të trajnuar për t'i mbrojtur ata.

Jo vetëm kaq, por, gjithashtu, kemi një rol të përfshirë për herë të parë, që është roli i urdhrave të psikologut dhe urdhrit të punonjësit social.

Në lidhje me ekspertët psikosocialë, që referohen në proceset e gjykatës, sa u përket tarifave, këto shërbime do të jenë falas, pra nuk do të ndikojnë në gjykim dhe në fund shpenzimet i shkojnë dhunuesit.

Petrit Vasili - Më falni, ne jemi shtet i së drejtës, në një proces gjykimi nuk parashikojmë dot kush do të jetë fituesi. Kështu që deri në momentin që fituesi mund të jetë pala tjetër shpenzimet e palës së dhunuar kush i merr përsipër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse avokatët punojnë falas?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Avokati i Dhomës së Avokatëve do të punojë falas për shtetin? Certifikimi dhe trajnimi është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, Dhoma e Avokatisë këtë shërbim, mbrojtjen ligjore të tyre do ta bëjë pa pagesë. Trajnimi është aftësim profesional, është çështje tjetër, por problemi është që shërbimi konkret, pra që ky njeri i dhunuar do të asistohet nga një avokat. Avokati, punon me tarifat përkatëse të caktuara. Pra, Dhoma e Avokatisë ka bërë marrëveshje me ju që këto raste do t'i bëjë pa para? Nuk më rezulton kjo gjë, por që është një gjë e mirë, duhet vënë në ligj e përcaktuar që Dhoma e Avokatisë do të marrë përsipër të ofrojë pa pagesë shërbimet avokatore.

Ogerta Manastirliu- Përcaktohet ndihma juridike e garantuar nga shteti sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike falas.

Petrit Vasili – Pyetja ime është: Cila është risia? Këtu kemi ardhur të ndryshojmë dhe ky është një përcaktim i vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Legjislacioni për këtë fushë dhe ligji për këtë çështje kanë qenë bashkë dhe e kanë respektuar këtë gjë. Kjo që referoni ju nuk ka dalë pas këtij ligji. Ligji ka dalë pas asaj, kështu që në këtë pikë është zgjidhja juaj.

Ogerta Manastirliu - Sa u përket qendrave të emergjencës

(Mungesë incizimi) minuta 08.....

Është duke krijuar këtë mekanizëm, i cili do të mundësojë një shpërndarje territoriale më të mirë të shërbimeve sociale të qendrave sociale, përfshirë këtu edhe qendrat e emergjencës për viktimat e dhunës në familje dhe parashikon mbështetjen financiare nëpërmjet këtij fondi, që është aktualisht duke u ngritur pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo do të lehtësojë në të gjitha bashkitë ngritjen e shërbimeve sociale dhe qendrat e emergjencës.

Pra, financimi është i garantuar, por, nga ana tjetër, është edhe një përgjegjësi e re për bashkitë për ngritjen e shërbimeve sociale, një përgjegjësi që ia ngarkon edhe ligji, një përgjegjësi që duhet ta marrin edhe në kuadër të përgjegjësisë së tyre për të mbështetur dhe për të ofruar shërbimet sociale për grupet në nevojë.

Petrit Vasili- Do të thotë që ky është një financim që do të bëhet vetëm nga pushteti lokal? Nuk do të ketë asnjë ndikim nga pushteti qendror?

Ogerta Manastirliu – Fondi social është një mekanizëm i ri që ministria po ngre, i cili përfshin buxhetin qendror. Sot ne financojmë 9 qendra në bashkëpunim me bashkitë, por që janë shumë pak në referim të asaj çfarë ne ose bashkitë duhet të bëjmë për ofrimin e shërbimeve sociale në territor. Është një fond që parashikon të ngrihet pranë nesh, por të veprojë si një fond ku bashkitë do të aplikojnë dhe do të vendosin edhe fondet e tyre për të ngritur shërbimet sociale.

Petrit Vasili – Ju referuat që disa nga qendrat e emergjencës ndodhen në qytetet: Përmet, Sarandë, Pogradec dhe mendohet në Roskovec. Problemi themelor është se fenomeni i dhunës është mjaft i përhapur në qytetet e mëdha që kanë përplasje popullatash nga shumë pjesë të territorit, prandaj pyeta se cili është roli juaj në këtë strukturë qendrore, pasi spontaniteti i konkurrimit të bashkive përballë fenomenit që rritet dhe është masiv në qendrat e mëdha, është një strategji që duhet ta bëni ju. Mekanizmi i fondit është një lloj granti konkurrues ku ai që paraqet një projekt më të mirë dhe më të plotë mund të fitojë, por, nëse ne mbetemi në periferi të problemit, ndërkohë që problemin e kemi shumë të përqendruar dhe nga pikëpamja statistikore, por edhe të frekuencës së tij në qendra të mëdha, kjo kërkon një qasje tjetër që instrumentet të ecin në raport me këtë gjë. Ajo që unë ju pyeta në mënyrë specifike ishte: sa na shkon përafërsisht nga 1 në 10, sepse nuk mund të themi se mund ta bëjmë si të na e sjellë Zoti për mbarë? Pra, kemi një kalkulim

paraprak, është varianti optimal dhe na duhen, po marr si shembull 15 apo 20 milionë dollarë, në dispozicion kemi 5 milionë dhe për këto që kemi duhet të bëjmë këtë strategji për momentin, duke u orientuar këtu dhe këtu, por prapë një vlerësim duhet, sepse asgjëkundi nuk kemi një vlerësim financiar se sa shkon kjo nismë. Risku i madh i kësaj është risi pozitive në ligj, pamundësi efektive në implementim.

Ogerta Manastirliu – A mund të përgjigjem?

Petrit Vasili – Po.

Ogerta Manastirliu – Ndoshta nuk e përfundova fjalën, sepse u ndala vetëm te qendra e emergjencës, që po financojmë rishtazi me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, me të cilët, është rasti t’jua them, jemi duke punuar për të gjitha protokollet, standardet e mbrojtjes, të rehabilitimit dhe të integritit të viktimave të dhunës në familje, por ajo çka dua të shtoj është se ne jo vetëm që nuk jemi në periferi, por jemi në qendër të qendrave.

Shërbimet tashmë janë hapur dhe financohen bashkërisht nga pushteti qendror dhe ai lokal, kemi qendrën “Vatra” në Vlorë, kemi dy qendra në Tiranë, të cilat prapë janë me partneritet, Ministria e Shëndetësisë dhe vetë qendrat financojnë nëpërmjet donatorëve apo pushtetit lokal. Në qarkun e Elbasanit është një institucion rezidencial i përkujdesit për gratë dhe vajzat viktima të dhunës në familje, viktima të trafikimit dhe viktima të mundshme të trafikimit. Kjo do të thotë se kemi një shpërndarje gjeografike të këtyre qendrave qoftë në qendrat e qyteteve të mëdha, por edhe në qytete më të vogla. Ne e vlerësojmë si shumë të rëndësishme jo vetëm shpërndarjen territoriale në bazë të të gjitha atyre problematikave të shfaqura nga ky fenomen, por vlerësojmë si shumë të rëndësishme edhe qasjen e protokolleve që këto qendra kanë për të funksionuar, për të mos ngritur vetëm qendra për hir të qendrave dhe për të pasur numra, por për të ofruar vërtetë shërbime konkrete, shërbime të integritit, shërbime të mbrojtjes, shërbime të përfshirjes për gratë, vajzat, por edhe për fëmijët, sepse ka shumë fëmijë që trajtohen në këto qendra.

Ajo çka ne jemi duke punuar janë standardet dhe protokollet e ofrimit të shërbimeve në këto qendra. Financimi i këtyre qendrave është një financim i qëndrueshëm, ku ne prej vitesh tashmë si qeveri financojmë qendra në bashkëpunim me këshillat e qarqeve, me bashkitë, gjithashtu, edhe me partnerë ndërkombëtarë në mënyrë që të krijojmë modele të mira për t’i replikuar edhe aty ku ka nevojë. Shpërndarja gjeografike, prandaj u ndala tek ato qendra që janë më të reja në funksion të ofrimit të shërbimeve ndaj grave viktima të dhunës në familje, apo vajzave dhe garancia për financimin është buxheti që Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka

për programet e përfshirjes, si dhe përgjegjësia që pushteti lokal ka për të financuar shërbimet në territor.

Pra, të bëra bashkë në fondin social kanë një efekt, që ju me të drejtë i quani vetitë absorbuese të bashkive, ku një bashki e vogël mund të punojë më shumë për të absorbuar fonde dhe për të ngritur shërbime, por ka edhe diçka tjetër që janë kriteret e vendosura për të shtrirë një shërbim. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale paralelisht për hapjen e fondit dhe përpara se të hapeshin thirrjet për propozime do të vendosë kriteret bazuar mbi një analizë të qartë të problematikës dhe të nevojave që ka territori për shërbime sociale.

Diku në një bashki mund të ketë nevojë për një shërbim për personat me aftësi të kufizuar, diku në një shërbim tjetër mund të ketë për gratë e dhunuara dhe të trafikuar, diku në një bashki tjetër mund të ketë për të moshuarit, por e rëndësishme është që të gjitha bashkitë të marrin përgjegjësitë e tyre për ndërtimin e shërbimeve sociale dhe ne t'i kemi të gatshme protokollet dhe standardet për t'u ofruar këtë shërbim.

Pra, siç jua thashë edhe më parë, është shumë e lehtë të ngresh një qendër, por është shumë e vështirë për të punuar me standarde dhe t'i kesh këto standarde të miratuara, madje për të vajtur edhe më tej edhe protokolle të kostifikuara për çdo rast apo përfitues në qendrat sociale, të cilat marrin shërbime dhe në rastin konkret viktimat e dhunës në familje. Për këtë çështje jemi duke punuar me agjencinë e Kombeve të Bashkuara për të gjitha standardet në qendrat tona të përkujdesit, qoftë rezidenciale, qoftë semirezidenciale, qoftë ditore apo me shërbime të pjesshme në mënyrë që të gjitha shërbimet që jepen të jepen sipas standardeve dhe të mos më pas financime në drejtime të gabuara apo të pamenduara mirë, siç kemi pasur në raste të tjera të evidentuara.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Kisha një korrigjim miqësor. Nisma që ne po diskutojmë sot në komision është për rastet e dhunës në marrëdhënies familjare, ndërsa çështja e trafikimit është një problem delikat më vete, por nuk është domen i këtij ligji...

(Diskutime pa mikrofon)

Sot ne kemi një objekt.

E dyta, nuk mora ndonjë përgjigje shteruese për sa i takon vlerësimit financiar. Ju mund të keni një mijë strategji, jam dakord me ju, por pa një analizë financiare se cili është niveli bazik që ne duhet të arrijmë dhe sa duhet për ta arritur atë. Mundësitë mund të mos i kemi, por e dimë se bën kaq dhe na duhet të mobilizohemi, por nuk e mora një përgjigje për këtë.

Për sa i takon shpërndarjes gjeografike, në qoftë se ajo që ju referuat shteron me aq dhe nuk keni ndonjë gjë tjetër për të shtuar, edhe këtu kam një korrigjim miqësor. Shpërndarja mbaron deri në Tiranë, ju mund t'i keni, por nuk na i referuat, në 4 qarqet e Veriut që janë: Shkodra, Lezha, Dibra dhe Kukësi, nuk na i referuat. Pra, në qoftë se ju nuk i keni për këto qarqet kjo tregon se kjo gjeografi ka problemet e saja.

Konkluzioni për përgjigjen tuaj është ky: nisma e madhe ligjore kërkon ristrukturim strategjik të kësaj gjëje, bërjen e projektit infrastrukturor, i cili duhet të jetë jo ai që realizohet, por ajo që synojmë të realizojmë dhe së bashku me këtë edhe fatura financiare, strategjia se çfarë do të ndodhë në momentin kur një donator tërhiqet dhe qendra duhet të vazhdojë të funksionojë, sepse ky nuk është një problem fakultativ, por i përhershëm dhe elementi i fundit duhet të jetë strategjia e buxhetimit të qëndrueshëm të fenomenit.

Zonja Gjermani, fjala për ju.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, doja t'jua kërkoja si mundësi që nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje të jetë i pranishëm në seancat dëgjimore dhe në takimet që do të kemi për ligjin, të cilin e kemi nesër. Pra, prania ime sot këtu është për nënkomisionin...

Petrit Vasili – Nuk jua kuptova kërkesën.

Eglantina Gjermani – Nënkomisioni për Barazisë Gjinore të mund të jetë i pranishëm edhe në seancat e tjera...

Petrit Vasili – Këtu! Këtë gjë e ka garantuar Kryetari i Kuvendit...

Eglantina Gjermani – Unë e di që është pjesë e Rregullores, prandaj kam ardhur...

Petrit Vasili – Janë të mirëpritur me kënaqësinë më të madhe.

Eglantina Gjermani – Faleminderit!

Doja të falënderoja ministren për prezantimin që na bëri, si dhe për ndryshimet që i janë bërë këtij ligji kaq të rëndësishëm. Unë mendoj se të gjitha ndryshimet janë të domosdoshme, madje pak të vonuara, për shkak të rritjes së numrit të denoncimeve të dhunës në familje, rritjes së frekuencës, edhe të rasteve të dhimbshme të rasteve të vrasjeve ndaj grave. Urdhri i mbrojtjes së menjëhershme është një nga ndryshimet e padiskutueshme si risi kryesore, por edhe një ndërhyrje e menjëhershme për viktimat e dhunës, prandaj mundësisht kërkoj edhe hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore dhe zbatimin e tyre sa më parë për të parandaluar tragjedi të tjera, duke kërkuar një rol më të fortë të të gjitha institucioneve që merren me trajtimin e rasteve të dhunës

ndaj gruas, po kështu edhe përcaktimi i përgjegjësiave, i afateve procedurale, të të gjitha institucioneve që merren me trajtimin e rasteve të viktimave të dhunës në familje.

Ajo që doja të theksoja për sa i përket ngritjes së qendrave të emergjencës, me aq sa kam parë, kjo është edhe angazhim personal, përveçse institucional, i kryetarëve të bashkive, edhe për sa i përket mekanizmit të referimit të dhunës, edhe për sa u përket ngritjes së qendrave të emergjencës për viktimat e dhunës, prandaj mendoj se jemi në momentin që t'u bëjmë thirrje të gjithë kryetarëve të bashkive, sepse kuadri ligjor ekziston si për ngritjen e mekanizmit të referimit të rasteve të viktimave të dhunës në familje, ashtu edhe për ngritjen e qendrave të emergjencës, të cilat janë të domosdoshme, për faktin se qendrat ekzistuese që ju përmendët si në Elbasan, në Vlorë, në Tiranë apo në zona të tjera kanë potencial deri diku të limituar, kështu që qendrat e emergjencës janë mëse të domosdoshme dhe njësitë vendore duhet të jenë të ndërgjegjësuara dhe institucionalisht të monitoruara për t'i ngritur këto qendra si domosdoshmëri.

Meqenëse ky ligj është mjaft i rëndësishëm, kisha edhe një pyetje tjetër, pasi hartimi i këtij ligji ka kaluar disa etapa dhe konsultime, prandaj doja t'ju pyesja për grupet e interesit, sepse për mua ka mjaft rëndësi përmbajtja e ligjit dhe procesi në të cilin ka kaluar. A keni bërë seanca bashkëbisedimi, dëgjesa me grupet e interesit, duke qenë se shoqëria civile është ajo që ka filluar shërbimet dhe ka dhënë shërbime prej shumë vitesh për viktimat e dhunës në familje, ndoshta edhe më herët sesa institucionet shtetërore? Nëse ju keni bërë seanca diskutimi me ta, marrje mendimesh, nëse i keni marrë në konsideratë apo jo parimisht, pa hyrë në detaje për të treguar që ndryshimet ligjore janë kaq të rëndësishme, por ama janë përcjellë edhe nga përvoja praktike e atyre që japin shërbime në këtë fushë. Mendoj se kritikën apo daljet publike të përfaqësuesve të shoqërisë civile kanë sugjeruar fuqishëm ndryshimin e ligjit. Ndaj, ju falënderoj sërish për faktin që keni dëgjuar këtë pjesë dhe i keni sjellë ndryshimet për t'i bërë menjëherë.

Pyetja e dytë, në fakt, është afatgjatë, meqenëse ligji për masat për dhunën familjare, që është bërë me një nismë qytetare vite më parë, i referohet kryesisht dhunës në familje. Nga të gjitha rekomandimet dhe konventat ndërkombëtare, është sugjeruar pasja e një ligji të ri, që adreson të gjitha format e dhunës ndaj grave. Nuk e di nëse e keni në planet tuaja hartimin e një ligji të veçantë, që të trajtojë të gjitha problemet e dhunës ndaj gruas në tërësi, meqenëse kjo i mungon kuadrit ligjor ekzistues.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Gjermani!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Vazhdojmë me sqarimet e ministres dhe më pas fjala për zonjën Spahi.

Ogerta Manastirliu – Për të ardhur deri këtu, ky projektligj ka kaluar të gjitha etapat e konsultimeve me të gjitha ministratë, me Avokatin e Popullit, me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me të gjitha palët e interesit dhe, gjithashtu, kemi realizuar shumë tryeza, por në datën 3 nëntor 2017 realizuam një tryezë shumë të gjerë me përfaqësues të shoqërisë civile, të organizatave joqeveritare, të subjekteve që punojnë në terren, gjithashtu edhe me përfaqësues të të gjithë strukturave të tjera shtetërore në kuadër të diskutimeve, shtesave, komenteve, sugjerimeve, të cilat i kemi marrë më parë se ta depozitonin këtë projektligj në qeveri për VKM.

Gjithashtu, projektligji është publikuar edhe në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për konsultim me publikun, ku janë reflektuar të gjitha ato sugjerime dhe komente bazuar në këto diskutime, tryeza konsultimesh dhe referime të tjera nga grupet dhe palët e interesit.

Sa i përket pyetjes së dytë nëse kemi në plan për të hartuar një ligj kuadër, përgjigja ime është po! Është në plan, pasi bëhet edhe në kuadër të konventës “SIDO”. Komiteti “GREVIO” e ka vendosur në përcaktimet e tij hartimin e një ligji kuadër, sa u përket të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Ne kemi vlerësuar emergjent plotësimin e vakumeve, të cilat i kishim konstatuar dhe marrjen e masave për të plotësuar dhe harmonizuar kuadrin ligjor ekzistues. Me të gjithë harmonizimin në kuadër të konventës së Stambollit, të konventës “SIDO” do të shkojmë në përpjekje për të ndërtuar një ligj, i cili pa dyshim do të kërkojë edhe kohën e tij për t’u angazhuar jo vetëm si qeveri, por të gjitha palët, edhe si parlament për të ndërtuar një ligj të ri kuadër për të gjitha format e dhunës kundër grave.

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Ministre!

Do të doja të bëj një sqarim para se t’ia jap fjalën zonjës Spahi: dy organizata joqeveritare “Rrjeti i Monitorimit Kundër Dhunës në Bazë Gjinore” dhe “Rrjeti Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve” kanë depozituar në komision një material, i cili do t’u bëhet disponibël të gjithë anëtarëve të komisionit, një seri vërejtjesh që lidhen me përcaktimet e ardhura në këtë ligj.

Sa më sipër, meqenëse sot jemi së bashku për këtë punë dhe nesër ata do të jenë këtu për një seancë dëgjimore, nuk është pyetje, por vetëm për të pasur një sqarim më shumë, në rast se ka pasur një komunikim me ta, pse nuk është bërë e mundur të shterohen një pjesë e mirë, sepse vërejtjet e tyre janë të shumta. Besoj se po të kishte pasur një komunikim me ta, shumica e tyre do të ishin ezauruar. Të dyja materialet janë të bollshme dhe me komente të shumta, ndaj mendoj që për një çështje me sensibilitet të tillë, ku në mënyrë të veçantë këto organizata jofitimprurëse kanë

pasur një rol shumë aktiv, në mjaft raste kanë qenë promotorët e këtyre ndryshimeve, besoj se kjo pjesë mund të ishte shteruar më mirë. Megjithatë, në fund të fundit, jemi ende në proces dhe s'ka asgjë të keqe. Këto vërejtje gjenden me vend si objekt reflektimi për ta përmirësuar nismën, sepse puna jonë këtu konsiston.

Fjala për zonjën Spahiu.

Klodiana Spahiu – Faleminderit!

Së pari, do të doja t'ju përgëzoja, sepse këto ndryshime, në fakt, ashtu siç thatë edhe ju, i kemi diskutuar në tryeza që prej shtatorit të vitit 2017 me grupet e interesit. Këto ndryshime kanë qëndruar për një kohë të gjatë në Ministrinë e Drejtësisë për t'u konsultuar. Mendoj se ndryshimet që kanë ndodhur kanë qenë të domosdoshme. Komisioni përgjegjës për këtë projektligj është Komisioni i Ligjeve dhe aty do të diskutohen me hollësi të gjitha ndryshimet që keni propozuar. Mendoj se ndryshimet e ndodhura në nenet 1,4,5,7 dhe 8, por sidomos ato ku përfshihen jo vetëm anëtarët e familjes tashmë në dhunë, por edhe bashkëjetuesit dhe njerëz të tjerë që nuk bëjnë pjesë te familjarët e afërt, janë shumë të rëndësishme. Duke u konkretizuar edhe me ngjarjet shumë të dhimbshme që kanë ndodhur kohëve të fundit, mendoj se këto ndryshime duhet të miratohen sa më shpejt. Jam e bindur se ju do të punoni të gjithë për të sjellë një ligj i ri në parlament për masat ndaj dhunës në familje.

Në seancën dëgjimore që do të bëjmë nesër, shpresoj që do të jenë edhe përfaqësuesit e ministrisë. Të gjitha mendimet dhe sugjerimet tona do t'i përcillen edhe komisionit përgjegjës. Unë isha edhe te Komisioni i Sigurisë ku u diskutuan këto ndryshime dhe shpresoj që pushteti vendor të jetë sa më pranë këtyre ndryshimeve.

Në qytetin e Durrësit para disa ditësh patëm një histori të hidhur. Pashë një angazhim të madh të të gjithëve dhe shpresoj që të ketë një bashkëpunim më të madh me drejtorinë e Mbrojtjes Sociale në lidhje me ndihmën ekonomike dhe me të gjithë faktorët e tjerë, që ndonjëherë agravojnë situatën.

Shpresoj shumë që forcimi i këtyre ligjeve të na japë një rezultat sa më konkret dhe të shpejtë në reduktimin e rasteve ekstreme, por edhe në reduktimin e rasteve të dhunës në familje.

Një pikë shumë e rëndësishme që ju e keni nënvizuar është edhe rehabilitimi i këtyre njerëzve që, për arsye nga më të ndryshme si alkooli apo çrregullimet mendore, të kenë rehabilitim sa më të shpejtë.

Pyetja ime është: pse duhet të qëndronte për muaj të tërë në Ministrinë e Drejtësisë ky projektligj?

Faleminderit!

Ogerta Manastirliu – Mendova se do të kemi edhe përfaqësuesin e Ministrisë këtu, pasi ishte pjesë e të ftuarve në këtë takim..

Besoj që edhe Ministria e Drejtësisë ka bërë disa tryeza konsultimesh së fundi kur ne i kemi çuar për mendime, dhe kjo ka qenë arsyeja pse ka pasur këtë vonesë.

Klodiana Spahiu – Domethënë edhe ata janë konsultuar me grupet e interesit dhe ende kanë mbetur...

Ogerta Manastirliu – Zëvendësministrja Voda është marrë posaçërisht me tryezat e konsultimit për këtë ligj.

Petrit Vasili – Kam edhe një sqarim që do të doja ta ndaja me ju lidhur me fushat e përgjegjësisë: u jam drejtuar me një letër Kryetarit të Kuvendit dhe Konferencës së Kryetarëve, pasi e kam gjetur krejtësisht pa vend që cilësinë e komisionit përgjegjës për këtë nismë ta ketë Komisioni i Ligjeve. Kjo nuk ka të bëjë absolutisht me protagonizëm, as me ndonjë qëllim të natyrave të tjera, sepse çdo debat që duam të bëjmë, mund ta konsumojmë, por ka qenë një qasje krejtësisht e gabuar kundër frymës së të gjitha konventave që kanë lidhje me dhunën në familje, kundër arsyes themelore, ndërkohë që, edhe nënkomisioni parlamentar përkatës për këtë çështje është i atashuar pranë këtij komisioni. Besoj se ka qenë një veprim shumë i gabuar jashtë vendit, jashtë kohës, i pamotivuar, pasi Komisioni i Ligjeve është korrektuesi i një instrument ligjor që përdoret atje. Thelbi nuk është thjesht dhe vetëm një element i caktuar ligjor, ai është një qasje tjetër e re ndaj fenomenit të dhunës në familje.

Sigurisht, e kam kërkuar dy herë, u konsiderua pa asnjë lloj argumenti, që ishte i pavend, ndonëse historia e këtij ligji flet ndryshe, pasi edhe kur është miratuar si ligj vite më parë, është miratuar këtu, jo se ishte sevda për ta bërë, por ishte fusha e përgjegjësisë, ishte qasja, kompetenca, instrumentet ligjore, që janë prezente në çdo lloj fushe të qeverisjes. Për këtë punë Komisioni i Ligjeve bën korrektimin ligjor të atyre elementeve, që kanë vend për ndonjë korrektim, që mund t'i kenë shpëtuar propozuesit, kurse thelbi është këtu. Sigurisht, ky është opinion im, për atë mundësi politike që kam për të imponuar. Kam provuar keqardhje shumë të madhe për anashkalimin e komisionit, kjo edhe për historinë, edhe për fushën e kompetencës, edhe për propozuesin në ekzekutiv, si fushë kompetence. Përcaktimi në këtë mënyrë dhe imponimi me një vullnet të njëanshëm, nuk i bëri ndonjë dëm as komisionit, as secilit nga ne dhe as mua personalisht. E thashë edhe një herë tjetër, debatin nuk na e pengon njeri ta bëjmë, por këtë vendosje anapulla, që nismën për dhunën në familje që e shqyrton Komisioni i Ligjeve, kudo që

të shkoni, në çdo vend tjetër të globit, nuk keni për të gjetur një parlament në botë që e bënë këtë punë. Komisionet e fushave janë ata që bëjnë promovimin e fortë, mbrojnë nismën dhe japin në publik dimensionin e ri që sjell nisma. Kjo duhet të ishte në të mirën e nismës dhe jo në të mirën e komisionit. Megjithatë, kjo është një histori e mbyllur. Nganjëherë, një mendje mbyllur ecën më mirë se një mendje e hapur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

U diskutua, por u gjet me vend, megjithëse ligji është miratuar këtu, megjithëse komisioni përkatës funksionon këtu, megjithëse Ministria e Shëndetësisë është promotorja, megjithëse, megjithëse, megjithëse, po na ka lindur një sevda e madhe që është më i mirë Komisioni i Ligjeve. Nuk dua të prish as gojën dhe as komentet, ju informova për të ditur se si qëndron puna dhe në çfarë mënyrë është kjo. Ky është një protagonizëm, që nuk e ndihmon të mirën e përbashkët jo të mirën e komisionit. Komisioni nesër ka seancë, por edhe sot, po të dojë, nëse ka interes, mund të debatojë edhe me orë të tëra, këtë nuk e pengon njeri, por të themi që ligjin për ndryshimet në dhunën në familje nuk e merr komisioni përkatës, i cili është aktivizuar me shumë të drejtë, sepse nënkomisioni që drejton zonja Gjermani është rikonceptuar në këtë funksion të ri, dhe konceptimi është ndryshuar në kuptimin pozitiv për t'i dhënë këtë dimension të ri dhunës në familje, pasi kemi pasur një tjetër konceptim në nënkomisionin e legjislaturës së shkuar... Megjithatë kjo nuk është ndonjë dramë, por ishte vetëm për transparencë me njëri-tjetrin për ta ditur se çfarë ka ndodhur.

Klodiana Spahiu – Pa dyshim që ju e keni bërë kërkesën tuaj, për ta pasur ky komision, por mendoj që ne po i zbatojmë të gjitha rregullat, madje po bëjmë edhe seancën dëgjimore, megjithëse komisioni për dhënie mendimi nuk e ka të detyruar seancën dëgjimore.

Petrit Vasili – Por kur u bë ligji për strehimin social Komisioni i Ligjeve bëri 4 seanca dëgjimore njëra pas tjetrës. Apo nuk është kështu?

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, a mund ta mbaroj, sepse kam edhe një kërkesë të vogël për ju?

Petrit Vasili – A është kështu? A jam korrekt me atë që po them?

Klodiana Spahiu – Ne kemi rënë dakord për çdo gjë që keni kërkuar, rëndësi ka që këto ndryshime të miratohen. Unë jo pa qëllim e pyeta ministren, përse kanë ndenjur për një kohë të gjatë këto ndryshime në Ministrinë e Drejtësisë? Sepse siç e shikojmë të gjithë, janë ligje dhe nene të cilat i përkasin shumë fushës juridike.

Petrit Vasili – Nuk është kështu.

Klodiana Spahiu – Dakord, ju keni mendimin tuaj.

Petrit Vasili – Kështu i bie që edhe ligji për fekondimin artificial, meqenëse ka dispozita ligjore t'i çojmë të gjitha te..

Klodiana Spahiu – Zoti kryetar, ju lutem, ju keni mendimin tuaj.

Petrit Vasili – Nuk shkon kështu.

Klodiana Spahiu – Unë nuk vij në parlament për të ofenduar.

Petrit Vasili – Unë nuk të ofendova, por po jap argumente.

Klodiana Spahiu – Unë dua të jap argumentin tim.

Petrit Vasili – Unë po jap vetëm argumente, nuk po të ofendoj.

Klodiana Spahiu – Dakord, rëndësi ka që të kemi vullnetin dhe dëshirën që të gjithë bashkë t'i miratojmë këto ndryshime.

Petrit Vasili – Kemi edhe autoritet ne, nuk jemi të shpërlarë që të na marrin nëpër këmbë njerëzit.

Klodiana Spahiu – Pa dyshim që autoriteti është maksimal, përderisa këtu kemi edhe prezencën e nënkryetares së komisionit dhe ju e kuptoni që dëshira e vullneti ynë është maksimal që këto gjëra të kalojnë sa më shpejt.

Unë kisha një propozim, nëse ju na e lejoni këtë gjë, dy prej anëtarëve të këtij komisioni janë në një takim në orën 12:30, nëse keni mundësi ta hedhim në votim projektligjin, do të na bënit nder.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Unë thashë si të doni. A doni ta ndërpresim këtu?

Klodiana Spahiu – Jo, nëse ju mendoni se janë shteruar pyetjet dhe nuk ka më diskutime...

Petrit Vasili – Unë kam edhe diçka të fundit për të thënë. Për sa i takon kohës së hartimit të projektimit të projektligjit, për mendimin tim, nga ana burokratike nuk ka pasur vonesa, nëse nuk jam i saktë ministria mund të më korrigjojë, pasi grupi përkatës i punës është ngritur në datën 10 tetor të vitit 2017. A është kështu e vërteta?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po grupi i brendshëm me datë 10.10.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në grupin e brendshëm të udhëhequr nga Ministria e Shëndetësisë ka pasur përfaqësues nga Ministria e Brendshme, nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve, nga Avokati i Popullit, nga komisioni dhe nga Ministria e Drejtësisë. Për t'iu kthyer, edhe një sekondë të vetëm idesë që ne nuk jemi këtu, zonja Spahiu, që shqyr që na begenisin dhe shqyr që na japin mundësi. Jo, kjo

është një fushë përgjegjësie që ky komision parlamentar e ka për detyrë ta bëjë. Këtë e bën me motivim, e bën me përgjegjësi institucionale, por edhe teknike, pasi mjaft gjëra kanë dalë. Prandaj, kjo nuk ka të bëjë me ndonjë imponim apo me ndonjë kapriço personale të timen, kurrën e kurrës, por ka të bëjë me fushën e përgjegjësisë së komisionit dhe jashtë kësaj gjëje nuk del asnjë interpretim tjetër. Sigurisht, është vota, e cila përmbys çdo gjë. Por unë nuk po vë ulërimën për këtë gjë dhe as që po e diskutoj, por që është një risi negative, është absolutisht negative.

Që ta mbyllim këtë debat, i bie që nënkomisioni parlamentar përkatës, si një instrument i ngritur enkas për këtë punë, duhet t'ia çojë Komisionit të Ligjeve. A mund të pranojmë? A komformohemi ne me këtë ide? Edhe ju mendoni si unë, por keni vështirësi kur ma jepni të drejtën.

Zonja Ministre, a keni ndonjë sqarim të fundit?

Kolegë deputetë, a keni pyetje të tjera?

Zonja Xhembulla, a kishit ndonjë gjë?

Almira Xhembulla – Faleminderit, zoti kryetar!

Sigurisht që e falënderoj ministren për informacionin, por më shumë besoj se duhet të jemi të kënaqur për ndryshimet, sepse, edhe ju iu referuat, shpeshherë ligji aktual kishte vështirësi në zbatueshmëri. Prandaj mendoj se këto ndryshime do të rrisin eficiencën e ligjeve të mëparshme, në aspektin e zbatueshmërisë.

Meqenëse iu referuat qarkut të Dibrës, dua të them që atje funksionon mekanizmi i referimit të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve në nivel qarku. Ndërkohë po punohet për ngritjen e një qendre pritëse 3-ditore për gratë dhe fëmijët, nga bashkia dhe kërkojmë mbështetje nga Ministria.

Për sa i përket asistencës ligjore falas, pikërisht besoj se edhe ndryshimet që sjell ky projektligj kanë të bëjnë me mënyrën e funksionimit më të mirë, sepse nga të gjitha raportet dhe monitorimet e nxjerra deri më tani të rasteve të dhunës, kam përshtypjen që nenet 11 dhe 12 të ligjit 111.2 “Për ndihmën juridike falas” nuk janë zbatuar. Këtë e kam, sepse kam qenë pjesë e diskutimeve të këtyre tryezave. Ndërkohë që duhet të merren hapa për detyrimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionit për Këshillim Ligjor dhe Ndihmën Juridike që ata ta zbatojnë këtë të drejtë që u jepet. Prandaj, sot duhet të jemi shumë pozitiv ndaj këtyre ndryshimeve që sjell ky projektligj.

Nuk po zgjatem më, sepse kisha edhe dy gjëra të tjera, por do t'i diskutoj në takimet e tjera.

Faleminderit!

Petrit Vasili – Faleminderit, zonja Xhembulla!

Besoj se diskutime më specifike do të bëhen në shqyrtimin e ligjit nen për nen, disa të tjera do të pasurohen edhe nga seanca dëgjimore. Sekretaria teknike do të shpërndajë të gjitha komentet dhe disa propozime të tjera që grupet e interesit kanë bërë. Besoj se janë të rëndësishme dhe duhet të kenë vëmendjen tuaj. Ministrisë së Shëndetësisë i sugjeroj që t'i ketë parasysh në diskutimin e saj, sepse disa prej tyre qëndrojnë dhe janë ndryshime që vërtet e pasurojnë draftin.

Lidhur me diskutimin në parim të projektligjit, kush është dakord për të votuar në parim ndryshimet?

Të gjithë pro. Kundër? Asnjë. Abstenim? Asnjë.

Miratohet.

Ka edhe një vërejtje zoti Pendavinji.

Ilir Pendavinji – Vërejtjen e kam për ty, sepse duhet të përplasësh këmbët në mbledhjen e kryetarëve për pjesën e ...

Petrit Vasili – Nuk e kam Klodin me vete.

Këtu e mbylлим dhe nesër kemi seancën dëgjimore.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA